



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 qershor 2020**, duke marrë për bazë aktakuzat e ngritura nga dhomat e specializuara të Gjykatës Speciale, ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas konsultimeve mes grupeve kuvendare në mënyrë unanime miraton këtë:

Deklaratë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të mbrojtjes së vlerave dhe luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, publikisht e mbështesim këtë deklaratë të përbashkët dhe besojmë në pastërtinë e luftës së UÇK-së.


Lidhur me këtë, ne Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

- Rikujtojmë , ballëhapur e faqebardhë se lufta e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi ka qenë një kërkesë e kamotshëm e popullit shqiptarë.
- Konsiderojmë se kauza e popullit shqiptar të Kosovës për çlirim e pavarësi ka qenë e drejtë, kurse UÇK-ja është jo vetëm pika më e lartë e përpjekjeve historike të popullit të Kosovës për liri e vetëvendosje, por edhe kapitulli më i lavdishëm i historisë sonë kombëtare.
- Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka zhvilluar luftë të pastër dhe të drejtë në përputhje të plotë me të gjitha normat, konventat, ligjet dhe standardet ndërkombëtare.
- Shteti serb ka ushtruar gjenocid ndaj popullsisë shqiptare, ka vrarë e masakruar civilë të pafajshëm vetëm se ishin shqiptarë. Përfshirë edhe masakrën e 2 Majit në Studime dhe masakrën e 22 Majit në Vushtrri që kanë mbetur ende pa u ndëshkuar.
- Shprehim solidaritetin tonë me udhëheqësit dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës veçanërisht Presidentin Hashim Thaçi dhe Kadri Veselin, të cilëve iu është ngritur aktakuzë për krime lufte. Ne besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre, dhe pohojmë se lufta e tyre ka qenë e drejtë dhe e pastër.

Shprehim mirënjohjen tonë për kontributin e secilit pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e Kosovës.

U jemi përjetësisht mirënjohës.

Vushtrri,
25 Qershor 2020

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

